

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI  
TË KUFIZUAR  
VENTURE CAPITALIST SHPK**

- Z. Aldenis Çullhaj, atësia Ilija datëlindje 21.09.1981 qytetar Shqiptar, me vendlindje në Elbasan, Shqipëri dhe banim në Tiranë,

sot më date 08.03.2022 kam vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është VENTURE CAPITALIST SHPK

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është Shqipëri, Tiranë, Njesia Nr.10, Rr. Reshit Çollaku, përballë Gjykatës së Lartë, kati 1 banimi.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4 - Objekti i shoqërisë**


4.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi. Agjensi për ndërmjetësim tregtar. Gjerimi i punëve të tjerëve (sipas parashikimeve të nenit 648-652 të Kodit Civil). Konsulencë juridike në fushën e legjislacionit fiskal, tatimor, e doganor; Përgatitje dokumentacioni, ndjekje e të gjitha procedurave për regjistrim të shoqërive të krijuara rishtazi, deri në dhënien e licensës nga organi përkatës për fillimin e ushtrimit të aktivitetit; Konsulencë juridike në marrëdhënie tregtare, përpilim dhe depozitim dokumentash të shoqërive tregtare të regjistruara si subjekte të së drejtës shqiptare apo të huaj. Konsulencë në distancë dhe me anë të përfaqesuesve të brendshëm pranë shoqërive tregtare. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

**Neni 5 - Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është Lekë 100,000 (njëqindmijë) i cili nuk është i paguar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar në nenin 6 (gjashtë) të këtij Akti.

**Neni 6 - Kontributet**

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:
  - Z. Aldenis Çullhaj, atësia Ilija datëlindje 21.09.1981 qytetar Shqiptar, me vendlindje në Elbasan, Shqipëri dhe banim në Tiranë të cilit i përket një kuotë, me vlerë nominale Leke 100,000 (njëqindmijë) që i korespondon 100% i kapitalit të Shoqërisë.

1  




### Neni 7 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

### Neni 8 - Administrimi

- 8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:
- Z. Aldenis Çullhaj, atësia Ilija datëlindje 21.09.1981 qytetar Shqiptar, me vendlindje në Elbasan, Shqipëri dhe banim në Tiranë , cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.2 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

### Neni 9- Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.
- 9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve si më lartë, versioni në italisht do të jetë i vetmi version ligjërish detyrues.

### Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

ORTAKU I VETEM

Aldenis Cullhaj

